

V E N D I M
Nr. 405, datë 19.6.2003

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.54, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SISTEMIN E PAGAVE TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK DHE
USHTARAKËVE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 3/1 të vendimit nr.54, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave, paga për emërtimin “Drejtor i Policisë së Burgjeve” të bëhet 75 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë në muaj.

Efekti financiar, që rrjedh nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano